

**LIGJ**  
**Nr.9982, datë 8.9.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9461, DATË 21.12.2005 "PËR  
NOMENKLATURËN E MALLRAVE DHE TARIFËN DOGANORE",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9461, datë 21.12.2005 "Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Kudo në ligj fjalët "Nomenklatura e mallrave" zëvendësohen me fjalët "Nomenklatura e kombinuar e mallrave (NK)".

**Neni 2**

Pas nenit 1 shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

**"Neni 1/1**

Në rastet e bashkimeve të kodeve të nomenklaturës së kombinuar të mallrave me nivele të ndryshme tarifore zbatohet, në çdo rast, niveli më i ulët tarifor, me përjashtim të rasteve kur, me ligj të veçantë, parashikohet ndryshe."

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5886, datë 17.9.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**